



FORÇA JONË

* * * Viti III • Nr. 21 • Shkurt 2014 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *



Ministri i FSK-së Agim Çeku priti ambasadorin e SHBA-ve, në NATO, Douglas Edward Lute

Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Agim Çeku me bashkëpunëtorë, priti në ambientet e Ministrisë, ambasadorin e SHBA-ve në NATO, Douglas Edward Lute të shoqëruar nga ambasadorja e SHBA-ve në Kosovë Tracey Ann Jacobson dhe anëtarë të tjerë të delegacionit. Ministri Agim Çeku e njoftoi ambasadorin Lute me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, me theks të posaçëm foli për punën që është bërë në Rishikimin e Sektorit Strategjik

të Sigurisë. Duke falënderuar ambasadorin Lute për kontributin e tij në NATO në përkrahje të FSK-së, ministri Çeku kërkoi nga ai që të vazhdojë ta mbështesë angazhimin e MFSK-së dhe Kosovës për anëtarësim në Programin e Partneritetit për Paqe të NATO-s. Nga ana e tij ambasadori Douglas Lute premtoi angazhimin e tij dhe SHBA-ve për të shtyrë përpara agjendat e Kosovës dhe të FSK-së për bashkëpunim me NATO-n.

Ndihmë e vazhdueshme e SHBA-së për MFSK-FSK-në




Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), z. Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së, gjeneralletjënant Kadri Kastrati, me bashkëpunëtorë, pritën në takime të ndara përfaqësuesin Ushtarak të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Komitetin Ushtarak të NATO-s (USMILREP), gjeneralletjënant David R. Hogg, i cili shoqërohej edhe nga atashu ushtarak i SHBA-s në Kosovë, koloneli James Kott. Ministri Çeku e gjeneral Kastrati e njoftuan gjeneralin Hogg me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, me theks të veçantë ata folën për punën që është bërë

në Rishikimin Strategjik të Sektorit të Sigurisë. Ministri Çeku gjithashtu paraqiti aspiratën e institucionit për fillimin e punës në drejtim të arritjes së vizionit për integritet euro-atlantike, aspiratë kjo e popullit të Kosovës, sepse historia me e re e Kosovës është e lidhur ngushtë me NATO-n. Ministri Çeku dhe gjeneral Kastrati e falënderuan gjeneralin Hogg për ndihmën e madhe që Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë dhënë për zhvillimin e FSK-së dhe profesionalizimin e saj. Gjithashtu, të parët e FSK-së, kërkuan nga gjeneral Hogg të vazhdoi të përkrahë angazhimin e FSK-së dhe të Kosovës për anëtarësimin në Programin e Partneritetit për Paqe të NATO-s. Ndërsa, gjeneralletjënant David Hogg premtoi angazhimin e tij dhe të SHBA-së për ta ndihmuar edhe më tej Kosovën dhe FSK-në.

Gjenerali amerikan Dempsey ia uron Komandantit të FSK-së gjeneral Kastratit Ditën e Pavarësisë

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneralletjënant Kadri Kastrati, më 11 shkurt 2014, pranoi një letër urimi nga Kryesuesi i Shefave të Shteteve të Bashkuara të Ushtrisë Amerikane, gjeneral Martin Dempsey. Gjeneral Dempsey në letër urimin drejtuar gjeneral Kastratit shprehet: "Në emër të pjesëtarëve të Forcave të Armatosura të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe në emër të Komandës së Bashkuar të Shefave të Shteteve, ju përgëzoj ju dhe pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës me rastin e Ditës së Pavarësisë." Më tej gjenerali amerikan, Martin Dempsey është shprehur në letër: "Kam shumë besim se miqësia dhe bashkëpunimi ndërmjet dy ushtrive tona do të rritet edhe

më shumë". Në fund gjenerali Dempsey ka shprehur edhe interesimin e tij që sa më shpejt ti shoh të publikuara rezultatet e Rishikimit Strategjik të



Sektorit të Sigurisë si dhe zbatimin e tyre. Ky ishte teksti i urimit që gjeneralletjënant Kadri Kastrati ka pranuar me rastin e Ditës së Pavarësisë nga gjenerali amerikan Martin Dempsey.



FSK-ja parakalon në gjashtë vjetorin e Pavarësisë

Me parakalimin e kuadrateve të gjitha një-sive të Forcës së Sigurisë së Kosovës, Policisë së Kosovës dhe Shërbimit Korrektues të Kosovës, në sheshin "Nëna Terezë" dhe "Zahir Pajaziti" të Prishtinës, filloi zyrtarisht, shënimi i manifestimit qendror të përvjetorit të gjashtë të

shpalljes së Pavarësisë të Republikës së Kosovës. Fillimisht presidentja Jahjaga dhe kryeministri Thaçi vendosën kurora me lule pranë shtatorësës së heroit të Kosovës Zahir Pajaziti, në nderim të të gjithë të rënëve për lirinë dhe Pavarësinë e Kosovës.

Trecy Jacobson: SHBA do të mbështesin gjithmonë Kosovën

Në përvjetorin e gjashtë të Pavarësisë së Kosovës, ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në Prishtinë, znj. Trecy Jacobson, në fjalën e saj, ka lexuar letërën e presidentit Barak Obama për Kosovën, ku pos tjerash thotë, në gjashtë vjetorin e Pavarësisë së Kosovës, nisja e bisedimeve me BE-në për marrëveshjen e stabilizim-asocimit shënon edhe një të arritur të rëndësishme të Kosovës. Me këtë dialog

udhëheqësit e Kosovës kanë thurë rrugën e Kosovës që do të përmirësojnë jetën e qytetarëve dhe do të çojë përpara synimet e saj drejt integriteteve evropiane" ndërsa, për sektorin e sigurisë, NATO-ja ka deklaruar se Forca e Sigurisë së Kosovës i ka arritur kapacitetet e plota operacionale dhe ka ndërmarrë përpjekje mbresëlënëse për rekrutimin e serbeve të Kosovës. (Vijon në faqen 4-5)

Kryeministri Hashim Thaçi shpalosi idenë për Forcat e Armatosura të Kosovës gjatë vizitës në FSK

Kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi, qëndroi për një vizitë pune në kazermën "Adem Jashari" të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), ku u prit nga stafi i lartë i MFSK-së, ministri Agim Çeku, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, zëvendësministri Muhamet Latifi e Bejtush Gashi, si dhe gjeneralë dhe oficerë të lartë të FSK-së.

Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, para stafit më të lartë të FSK-së, në kazermën "Adem Jashari" tha: "Themelimi i Ministrisë së Mbrojtjes dhe krijimi i Forcave të Armatosura të Kosovës, janë segmente përmbyllëse të institucioneve që rrumbullakojnë shtetësinë e Kosovës."

I pari i Qeverisë, Hashim Thaçi, tha gjithashtu se FSK-ja është storje e suksesshme e ndërtimit dhe ngritjes së një strukture të rëndësishme të Republikës së Kosovës. Ai tha se që nga janari i vitit 2009, Forca e Sigurisë së Kosovës u themelua si forcë e sigurisë profesionale, e armatosur, e uniformuar dhe me përbërje shumetnike dhe se themelimi, zhvillimi, strukturimi dhe organizimi i FSK-së që nga fillimi është bazuar në praktikën më të mira të shteteve me demokraci të zhvilluar.

Kryeministri Thaçi, në fjalën e tij shtoi: "Deri më tani Forca e Sigurisë së Kosovës ka kryer operacione të kërkim-shpëtimit, asgjësimit të mjeteve të pashpërthyer, zjarrfikjes dhe detyrat të tjera të caktuara të asistencës humanitare. Forca e Sigurisë së Kosovës mund të

krenohet me shumë arritje të realizuara brenda mandatit të saj të tanishëm. Tani, është koha kur ne duhet të marrim përgjegjësinë e plotë për sigurinë e shtetit tonë, e kjo do të nënkuptojë ndryshime të rëndësishme në mandatin, misionin, madhësinë dhe strukturën e saj. Pra Forcat e Armatosura të Kosovës do të zhvillohen ashtu që të janë të gatshme dhe të afta ta mbrojnë sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Kosovës, do të mbrojnë interesat e Kosovës, qytetarët e saj dhe pronën e tyre, do të



Ministri dhe Komandanti i FSK-së në nderim të së kaluarës së lavdishme

Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati së bashku me oficerë të lartë të FSK-së, përvjetorin e gjashtë të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, e filluan pikërisht në Kompleksin Memorial "Adem Jashari", në Prekaz, ku bënë homazhe dhe vendosen kurora me lule.

Në Prekaz, për homazhe ishte edhe ministri i MFSK-së, z. Agim Çeku, së bashku me delegacionin e Qeverisë së Kosovës. Me këtë rast, ministri Çeku dhe gjeneral Kastrati çmuan lartë sakrificën e pashembullt të familjes Jashari për Liri dhe Pavarësi.



kontribuojnë për ndërtimin dhe ruajtjen e stabilitetit rajonal dhe atij global.

Aftësia që ne vet, shtoi kryeministri, ta mbrojmë vendin tonë dhe t'i plotësojmë nevojat tona të sigurisë është, po ashtu, parakusht për integritetin e suksesshëm të Kosovës në strukturat veri-atlantike.

Në fund, kryeministri Thaçi tha se në rrugëtimin tonë të mëturshëm drejt zhvillimit të Forcës së Mbrojtjes, ne do të vazhdojmë bashkëpunimin e ngushtë me miqtë dhe partnerët tanë, të cilët i falënderoj për ndihmat e pakursyera që kanë dhënë në këtë drejtim.

Ndërsa, ministri i FSK-së, Agim

Çeku, tha se arsyeja e vizitës së kryeministrit është që së bashku me ne të ndajë vizionin e tij, projektin e tij, e që në manifestimin qëndror të 17 Shkurtit, në përvjetorin e pavarësisë e dha një lajm të mirë, shumë të pritshëm për Kosovën, një lajm ku përfundimisht po përmbyshen pritjet e ushtarëve të Kosovës, ku po përmbyshet e drejta legjitime e Republikës së Kosovës për të pasur Ushtarinë e vetë dhe po realizohet ëndrra e çdo qytetari të Kosovës.

Në fund, ministri Çeku premtoi se FSK-ja do të vazhdojë edhe në të ardhmen të punojë me përkushtim. "Deri sa të miratohet ligji i ri në Parlament, ne do të vazhdojmë punën edhe gjatë këtij mandati me përkushtim të njëjtë, me entuziazëm të njëjtë, dhe me një optimizëm të madh".

Në fund, kryeministri së bashku me ushtarë, oficerë dhe nënoficerë të FSK-së, drekuan në kuzhinën e FSK-së.



Komandanti i FSK-së pranoi një letër urimi për Pavarësin e Kosovës nga komandanti i Komandës së Bashkuar të SHBA-ve për Evropë, gjeneral Breedlove

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Kadri Kastrati pranoi një letër urimi me rastin 17 Shkurtit -Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës nga gjenerali me katër yje Philip M. Breedlove, komandant i Komandës së Bashkuar të SHBA-ve për Evropë.

Gjenerali Breedlove në emër të ushtarakëve të Komandës së Bashkuar të SHBA-ve për Evropë, në letrën e tij shprehet se i uron komandantit të FSK-së dhe nëpërmjet tij edhe të gjithë pjesëtarëve të FSK-së Ditën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Më tej në letrën e tij gjenerali Breedlove shkruan se: "Përmbyllja e procesit nga FSK-ja e ka bërë këtë institucion shembull të shkëlqyer të suksesit në regjion." Unë, ka vazhduar më tej në letër gjenerali amerikan Breedlove, e çmoi lidhësinë tuaj në bërjen e FSK-së pjesë e integriteteve regionale si dhe në punën e përbashkët për të ecur përpara në partneritet të ngushtë me Komandën e Bashkuar të SHBA-ve për Evropë (USEUCOM) dhe NATO.

Lidhjet e ngushta ndërmjet Kosovës dhe SHBA-ve janë thelluar në vazhdimësi edhe përfaqësojnë një shembull pozitiv për rajonin e Ballkanit", përfundon letrën gjenerali amerikan Breedlove, duke ritheksuar se Ai do të vazhdojë të angazhohet për Kosovën edhe më tutje, dhe se lutet që pagja dhe prosperiteti ta përcjell Kosovën për shumë e shumë vite tjera.

Ministri i FSK-së Agim Çeku dhe Atasheu ushtarak i Gjermanisë nënkolonel Rupert Steeger nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi për emërimin e këshilltarit gjerman në MFSK

Ministri për ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), Agim Çeku priti në takim Atasheun ushtarak të Republikës së Gjermanisë, nënkolonel Rupert J.J. Steeger, pas të cilit nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi.

Marrëveshja e nënshkruar ndërmjet të dy ministrive e rregullon çështjen e emërimit të një këshilltari gjerman për çështje logjistike në ministrinë për Forcën e Sigurisë.

Në tekstin e marrëveshjes janë të definuara fushat konkrete që e intensifikojnë bashkëpunimin në fushën e sigurisë, gjithashtu edhe misionin, rolin, detyrat dhe përgjegjësitë e këshilltarit gjerman që do të jetë i integruar në kuadër të ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Në takim, si dhe gjatë nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit për emërimin e këshilltarit gjerman për çështje

logjistike në Ministri, ishte i pranishëm edhe ushtari i detyrës së shefit të Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri në MFSK, nënkolonel Hasan Hoxha. Marrëveshja e sotme e bashkëpunimit është rezultat i bashkëpunimit të dy ministrive dhe konform Marrëveshjes Bilaterale që ka Ministria e Forcës së Sigurisë me Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës Federale të Gjermanisë.



Ministri Agim Çeku e dekoroi me Medalje, komandantin e Gardës Kombëtare të IOWA-s, gjeneralmajorin Timothy Orr

Ministri dhe Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, Agim Çeku dhe gjenerallejtënant Kadri Kastrati, pritën në takime të ndara komandantin e Gardës Kombëtare të Iowa-s, gjeneralmajorin Timothy Orr, me bashkëpunëtorë.

Ministri Çeku dhe gjeneral Kastrati falënderuan komandantin e Gardës Kombëtare të IOWA-s, gjeneralin Orr, për ndihmat e vazhdueshme profesionale që po japin për FSK-në. Ata, gjithashtu, njoftuan delegacionin e Amerikës për të arriturat e përgjithshme të FSK-së, si dhe për Rishikimin Strategjik të Sektorit të Sigurisë.



Me këtë rast, ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Agim Çeku, në shenjë mirënjohje për angazhimin dhe kontributin e dhënë për zhvillimin dhe profesionalizimin e FSK-së, komandantin e Gardës Kombëtare të

IOWA-s, gjeneralmajorin Timothy Orr e dekoroi me medalje,

"Për shërbim meritur, për kontribut të jashtëzakonshëm, partneritet dhe mbështetje të vazhdueshme në zhvillimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, në një institucion profesional, kompetent dhe të aftë"

Ndërsa, komandanti i Gardës Kombëtare të IOWA-s, gjenerali Orr, falënderoi ministrin Çeku dhe komandantin e FSK-së, gjeneral Kastratin, për dekoratën dhe për bashkëpunimin e deritashëm si dhe premtori thellimin e këtij bashkëpunimi në të ardhmen.



Nënshkruhet Programi i Bashkëpunimit në mes Ministrisë së Mbrojtjes të Sllovenisë dhe Ministrisë së FSK-së



Një delegacion i Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Sllovenisë, qëndroi për një vizitë zyrtare pune, në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, ku u prit nga drejtori i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri në MFSK-së, nënkolonel Hasan Hoxha. Delegacionin e Ministrisë së

Sllovenisë e priti edhe ministri i FSK-së, z. Agim Çeku, i cili fillimisht e falënderoi Qeverinë dhe Ministrinë e Mbrojtjes së Sllovenisë për ndihmat që ajo po jep për FSK-në, si dhe e njoftoi për të arriturat e përgjithshme të FSK-së, për bashkëpunimin rajonal, ndërkombëtar dhe për zhvillimin e FSK-së, në të



ardhmen. Ky takim u realizua në kuadër të Marrëveshjes për Bashkëpunim Bilateral në mes Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Sllovenisë, të nënshkruar gjatë vitit 2013. Qëllimi i vizitës ishte vazhdimi i bashkëpunimit të dyanshëm,

shkëmbimi i përvojave dhe njohurive në fushën e përgjithshme në mes dy ministrive, asaj të FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Sllovenisë.

Më pastaj, të dy delegacionet në përbërje të zgjeruar i vazhduan punimet gjatë ditës, me ç'rast edhe drejtori i Drejtorisë për Politikë dhe Plane, z. Faruk Geci,

bëri një prezantim lidhur me mënyrën dhe format e bashkëpunimit të mëtejshëm, me qëllim që të përfitohen njohuri dhe eksperiencat e dyanshme.

Në fund u nënshkrua marrëveshja për bashkëpunim, "Programi i Bashkëpunimit Bilateral për vitin 2014", nga nënkolonel Hasan Hoxha, drejtor i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri në MFSK dhe z. Gregor Zupan, shef i Sektorit të Marrëdhënieve Multilaterale në Ministrinë e Mbrojtjes së Sllovenisë.

Në kuadër të këtij Programi janë paraparë nëntë (9) aktivitete, përfshirë këtu trajnime të ndryshme në institucionet e arsimit ushtarak të Sllovenisë, vizitat e ekspertëve me qëllim të shkëmbimit të përvojave në fusha të ndryshme, si dhe avancimi drejt integriteteve euro-atlantike.

Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati priti fëmijët e "SOS-Fshatit"

Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Kadri Kastrati, së bashku me stafin e tij, pritën 50 fëmijë të "SOS-Fshatit" nga Prishtina, të grupmohave gjashtë vjeçare (lindur me Pavarësinë e Shtetit të Kosovës), në ambientet e FSK-së.

Gjeneral Kastrati pasi i përshëndeti fëmijët dhe arsimtarët, shtoi: "Sot, jam njeriu më i privilegjuar dhe më i lumtur, për këtë vit, që i pres fëmijët e moshës së krijimit të Shtetit të Kosovës". Më pas ai foli për aktivitetin e ushtarëve, shkollimin dhe punët e tjera që i



kryejnë pjesëtarët e FSK-së. "A është vështirë të bëhesh ushtar? Me çka merren ushtarët? Ishin këto disa nga

pyetjet e fëmijëve, që ia drejtuan komandantit. Shumica e tyre, në pyetjen e komandantit, se çka do të bëheni kurrë të



rriteni, shprehën dëshirën për t'u bërë ushtarë të Kosovës. Në fund, fëmijët u shprehën të lumtur për vizitën e tyre në

FSK, dhe gëzimin e tyre e shprehën duke kënduar këngët : Xhamadani Vija-Vija dhe Himni i Flamurit.

Manifestimi qendror i Pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt, u mbajt në sheshin "Nëna Terezë" dhe "Zahir Pajazitit"

FSK-ja parakaloi në gjashtë vjetorin e Pavarësisë

Me parakalimin e kuadrateve të të gjitha njësisve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, Policisë së Kosovës dhe Shërbimit Korrektues të Kosovës, në sheshin "Nëna Terezë" dhe "Zahir Pajazitit" të Prishtinës, filloi zyrtarisht, shënimi i manifestimit qendror të përvjetorit të gjashtë të shpalljes së Pavarësisë të Republikës së Kosovës.

Kryeministri Thaçi parajaimëtoft formimin e FA në shënimin e përvjetorit të gjashtë të Pavarësisë së Kosovës

Në manifestimin qendror me rastin e gjashtë-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi, në fillim e tij për të pranishmit shoi: "Sot, para nesh është e rreshtuar dhe e gatshme për parakalim Forca e Sigurisë së Kosovës, për të shënuar solemnisht gjashtë-vjetorin e Pavarësisë së shtetit tonë të lirë dhe demokratik. Prandaj është ndër dhe privilegj që t'ju drejto-



ri, ju kemi kaluar nëpër cisa faza të rëndësishme, gjithnjë duke ruajtur kontinuitetin, qëllimin dhe arsyet strategjike në shërbim të qytetarëve të Kosovës dhe mbrojtjes së vendit tonë.

Prandaj, e themi me krenari, se Forca e Sigurisë së Kosovës është vërtet një storie e suksesshme e ndërtimit dhe ngjites së një institucioni të rëndësishëm të Kosovës.

Shumica nga ju kemi dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, keni dhënë kontribut të vlerësuar dhe pranuar botërisht në kuadër të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, duke bashkëpunuar ngushtë me ekspertët e shteteve mike të Kosovës, me ekspertët e NATO-s dhe të KEFOR-it.

Shpallja e Kosovës Shtet i Pavarur dhe Sovran, gjashtë vjet më pare, krijoi kushte që TWMK-ja të hyjë në një fazë të re.

Që nga janari i vitit 2009, Forca e Sigurisë së Kosovës u themelua si forcë e sigurisë profesionale, e Kosovës është ngritur, zhvilluar

dhe është bërë më e fortë dhe më profesionale.

Deri tani Forca e Sigurisë së Kosovës ka kryer operacione të kërkim-shpëtim, asgjësimi të njëjleve të pashpërtijera, zjarri-fikjes dhe detyrat të tjera të caktuar të asistencës humanitare.

Forca e Sigurisë së Kosovës mund të krenohet me shumë arritje të realizuara brenda mandatit të saj të tanishëm.

Por, tash është koha të vazhdojmë tujtje.

Tash është koha kur ne duhet të marrim përgjegjësinë e plotë për sigurinë e shtetit tonë.

E kjo do të nënkuptojë ndryshime të rëndësishme në mandatin, misionin, madhësinë dhe strukturën e saj.

Kjo do të thotë - një emër i ri për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Të nderuar oficerë të FSK-së, Të nderuar qytetarë të Kosovës, Kjo është parada e fundit e ndërtimit të Dijës së Pavarësisë, ku ne e shohim parakalimin e

Oë nga themelimi i FSK-së ju kemi bërë një punë të jashtëzakonshme, prandaj sot edhe njëherë si kryeministër i Qeverisë së Kosovës, ju uroj dhe përgëzoj, për punën tuaj të jashtëzakonshme.

Të nderuar oficerë dhe ushtarë të FSK-së,

Të nderuar qytetarë të Kosovës, Edhe njëherë si kryeministër i Kosovës, ju urojmë 6 vjetorin e Pavarësisë së Kosovës. Zoti e bekoftë Kosovën dhe qytetarët e saj! Urmel!

Ambasadorja Tracy Jacobson: SHBA-të do të mbështesin gjithmonë Kosovën

Në përvjetorin e gjashtë të Pavarësisë së Kosovës, ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në Prishtinë, znj. Tracy Jacobson, në

fillim e saj, ka lexuar letërën e presidentit Barak Obama për Kosovën, ku pos tjerash thotë, në gjashtë -vjetorin e Pavarësisë së Kosovës, nisja e bisedimeve me BE-në për marrëveshjen e stabilizim-asocimit shënon edhe një të ardhur të rëndësishme të Kosovës.

Me këtë dialog udhëheqësit e Kosovës kanë thurë rrugën e jetën e qytetarëve dhe do të çojë përpara symmet e saj drejt integritetit dhe kapacitetit të Kosovës. Me këtë dialog udhëheqësit e Kosovës kanë thurë rrugën e jetën e qytetarëve dhe do të çojë përpara symmet e saj drejt integritetit dhe kapacitetit të Kosovës.

Në fund, ambasadorja Jacobson, ka thënë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të vazhdojnë të përkrahin dhe të mbështesin gjithmonë shtetin e Kosovës si të pavarur, sovran shumetnik dhe demokratik.



besimin se ato ekzistojnë për ti mbrojtur ata.

Jam e bindur se përkushtimi ynë për ti ruajtur vlerat e idealit mbirënjohjen tme për Policinë e Kosovës dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës, këtyre dy institucioneve më të besueshme për qytetarët e Kosovës dhe institucioneve që dëshmojnë sa i palëkundshëm është sovraniteti ynë, po aq sa edhe vizioni ynë për integritin në NATO.

Suksesi i reformimit dhe profetizimit të tyre që na kanë ndihmuar përgjatë gjithë historisë sonë. Në radhë të parë Shtetet e Bashkuara të Amerikës por edhe vendet e Bashkimit Evropian".

Në fund presidentja Anliete Jahjaga, duke ju drejtuar qytetarëve të Kosovës, tha se: "Ne kemi ende punë për të bërë në realizimin e ëndrrës së atyre që vendosën themeliet e shtetit, duke regjuar, sot, vendosmërinë për ta krijuar shtetin e së drejtës, të bazuar mbi rend dhe ligj që shprehin vlerat e demokracisë dhe të secilit qytetarë të vendit.

Në duar tona - qytetarë të Republikës së Kosovës - qëndron vetë suksesi i shtetit tonë. Në duart e të gjithë neve, njerëz të barabartë të këtij shteti, qëndron shembulli të demokracisë së zhvilluar, ku gjithëpërfshirja nënkupton edhe obligim dhe përgjegjësi dhe secili qytetar murrëkuptim nga të gjithë.

komandantin legjendar Adem Jashari.

Në këtë gjashtë-vjetor të pavarësisë, dua në veçanti të shpreh mirënjohjen tme për Policinë e Kosovës dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës, këtyre dy institucioneve më të besueshme për qytetarët e Kosovës dhe institucioneve që dëshmojnë sa i palëkundshëm është sovraniteti ynë, po aq sa edhe vizioni ynë për integritin në NATO.

Suksesi i reformimit dhe profetizimit të tyre që na kanë ndihmuar përgjatë gjithë historisë sonë. Në radhë të parë Shtetet e Bashkuara të Amerikës por edhe vendet e Bashkimit Evropian".



sionalizimit tuaj të mëtufteshëm është i garantuar falë guximt, kurajës, durimit dhe zotimit për ta përmbyshur misionin tuaj për një Kosovë paqësore dhe demokratike, për një shoqëri që ka për synim parësor investimin dhe frymën dhe shpirtin dhe e bëjë të përjetshme, me idealin e tyre ata që bëjnë lufën - të gjithë ata burra e gra të UÇK-së, me

demokratik.



Komandaniti i FSK-së gjeneral Kastrati dhe Komandanti i Gardës Kombëtare të Iowa-s gjenerali Orr, përcollën nga afër demonstrimin e shkathtësive taktike luftarake të FSK-së, në Pomozotin dhe Istog

Komandaniti i FSK-së gjenerallejtnant Kadri Kastrati së bashku me komandantin e Gardës Kombëtare të Iowa-s, gjeneralmajorin Timothy Orr, së bashku me bashkëpunëtorë, më 14 shkurt, vizituan Regjimentin e Mbrojtjes Civile të FSK-së, në Pomozotin dhe Brigadën për

Reagim të Shpejtë në Istog. Gjeneralët Kastrati dhe Orr u pritën nga stafi udhëheqës i RMC-së, kolonel Shaip Haziri dhe i BRSH-së, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, të cilët gjerësisht i njoftuan gjeneralët me aktivitetin e deritanishëm, trajnimet dhe të arriturat e

përgjithshme. Më pas të dy gjeneralët nga afër përcollën demonstrimet e shkathtësive taktike, të pjesëtarëve të FSK-së në Pomozotin, lëshimi me litarë dhe dhënia e ndihmës personave në nevojë, ndërsa në Istog pjesëtarët e BRSH-së demonstuan



shkathtësitë e tyre taktiko-luftarake. Në fund të dy gjeneralët u

impresionuan me demonstrimin e shkathtësive të pjesëtarëve të FSK-së, të cilët edhe i përgëzuan për përparimet dhe arritjet profesionale të tyre. Komandaniti i FSK-së, gjeneral Kastrati dhe komandanti i Gardës Kombëtare të Iowa-s, gjenerali Orr, u pajtuan që së bashku t'i avancojnë marrëdhëniet dhe bashkëpunimin në mes të FSK-së dhe Gardës Kombëtare të IOWA-s, në shumë fusha me interes të përbashkët.



Komandaniti i FSK-së gjeneral Kastrati mori pjesë në ndërrimin e Komandës në Kampin Bondsteel

Më 13 shkurt 2014, komandaniti i FSK-së, gjenerallejtnant Kadri Kastrati, me ftesë zyrtare, mori pjesë në ceremoninë e organizuar me rastin e ndërrimit të komandës në Kampin Bondsteel. Gjeneral Kastrati përcolli nga afër ceremoninë, dhe njëherësh përshëndeti KFOR-in për ndihmën e dhënë për FSK-në dhe Kosovën.

Me këtë rast, komandaniti i Ushtrisë Amerikane David J. Woods, ia dorëzoi komandën Kolonelit të Ushtrisë Amerikane Charles T. Hansley. Koloneli Woods, tha: "Për mua, puna në këtë mision ishte unike. Operacionet në mbështetje të paqes gjithmonë ndryshonin dhe çdo ditë përballësha me sfida të ndryshme".

Më pas, ai falënderoi njësitet vartëse dhe partnerët shumëkombësh, të cilët i ndihmuan atij, "të gjejë zgjidhje për sfida" dhe "reflektuan pozitivisht" përkushtimin e tyre për vendet

dhe ushtarët e tyre si dhe për popullin e Kosovës. Koloneli Woods gjithashtu tha se ushtarët që përbëjnë rotacionin e 18-të të KFOR-it, do të jenë një "ekip dinamik" dhe shprehu bindjen e tij se ata do të ruajnë "standardet e larta profesionale që vijnë së bashku me të qenit pjesëtarë të këtij ekipi të lidhur fort".

Ndërsa, komandaniti i KFOR-it, gjeneralmajori Salvatore Farina, përmendi një listë të gjatë të të arriturave të KFOR-it 17-të, përfshirë krijimin e njësitit të përbashkët në pjesën veriore të Kosovës, e cila iu është përgjigjur 132 thirrjeve për ndihmë rreth mjeteve të paspërthyerë dhe ka kryer 23 misione për evakuime mjekësore me helikopter.

Ajo që është më e rëndësishme, theksoi Farina, është se ushtarët e rotacionit të 17-të të KFOR-it kontribuon në rritjen e ambientit të qetë dhe të sigurt në tërë



Kosovën. "Prania dhe veprimi juaj kanë kontribuar në masë të madhe për të pasur një ambient të qetë dhe të sigurt dhe liri të lëvizjes këtu në Kosovë", shtoi Farina. Për komandantin e sapoemëruar të Grupit Luftarak Shumëkombësh - Lindje, kolonelin Hensley, gjener-



al Farina tha se detyrat e mëherëshme ushtarake të Hensley-t do

të shërbejnë si "parakushte më të mira për të pasur sukses në këtë mision të ndërlikuar".

Në fund të fjalës përmbilëse, para një audience të përbërë nga disa qindra ushtarë nga kombe të ndryshme, udhëheqës ushtarak dhe mysafirë të ndryshëm, gjeneral Farina lavdëroi ushtarët e KFOR-it dhe tha se asnjë komandant nuk do të mund t'i kryente detyrat e komandimit pa pasur ushtarë të përkushtuar ndaj misionit në Kosovë.

"Më lejoni t'ju siguroj se kam qenë me ushtarë shumë herë në veri dhe në lindje, dhe mund t'ju them se ata janë ushtarë me vlerë të madhe dhe ata kanë bërë ndryshim të madh. Krenohem me punën që e kanë bërë. Krenohem shumë me ju, ushtarë të Grupit Luftarak Shumëkombësh - Lindje".

Nga Kapiteni i Ushtrisë Amerikane Kevin Sandell Detashmenti i 11-të i Zyrës për Marrëdhënie me Publikun

Në ministrinë për FSK u mbajt takimi me Komisionin Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikqyrje të FSK-së

Ministri Agim Çeku ishte nikoqir i takimit të udhëheqësve të MFSK-së dhe FSK-së, si dhe Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikqyrje të FSK-së.

Në takim ishin të pranishëm edhe komandaniti i FSK-së, gjenerallejtnant Kadri Kastrati, zëvendësministri Muhamet Latifi dhe Bejtush Gashi, sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj, dhe gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, zëvendëskomandant i Komandës së Forcave Tokësore. Ndërsa Komisioni Funkcional për Siguri i Kuvendit të Kosovës i kryesuar nga kryetari



Ahmet Isufi, si dhe anëtarët; Rexhep Selimi, Goran Marinković, Ganimete Musliu, Anton Çuni, Fatmir Xhelili, Danush Ademi dhe

Rasim Demiri. Ministri Agim Çeku në fillim të takimit e njoftoi kryetarin Isufi dhe anëtarët tjerë mbi zhvillimet e deri-

tanishme në FSK, për procesin nëpër të cilin po kalon ky institucion si dhe për rezultatet e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë. Ministri Çeku, gjithashtu, edhe në cilësinë e shefit ekzekutiv të këtij procesi tha se na nevojitet mbështetja edhe e Komisionit Parlamentar për Siguri si edhe mbështetje e gjithanshme politike për synimet tona, lidhur me këtë proces. Sekretari i përgjithshëm i MFSK-së, Shkëlzen Sylaj paraqiti një raport të punës dhe të arriturave për vitin 2013 si edhe objektivat e ministrit për vitin 2014.

Nga ana e tyre anëtarët e Komisionit

Funksional për Siguri të Kuvendit të Kosovës shprehen interesim dhe parashtruan një varg pyetjesh që kishin të bënin me rekomandimet e procesit të Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë.

Në fund kryetari i Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikqyrje të FSK-së, Ahmet Isufi u shpreh se vazhdimisht ka qenë i kënaqur me të arriturat e ministrisë dhe FSK-së, dhe se në emër të Komisionit që ai drejton ofroi mbështetje të gjithanshme në kuadër të detyrës, që procesi nëpër të cilin po kalon FSK-ja të përmbillet me sukses.

Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës bashkoi femrat e të gjitha institucioneve të sigurisë së vendit në një tryezë pune në MFSK

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), përkatësisht Departamenti për Marrëdhënie me Publikun dhe Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore në MFSK, organizuan me 13 shkurt 2014 takim zyrtar, me qëllim të thellimit të bashkëpunimit ndër-institucional në fushën e sigurisë, përkatësisht femrat që shërbejnë në uniformë, si edhe promovimin e barazisë gjinore në të gjitha institucionet e sigurisë së Kosovës. Të pranishëm në takim ishin edhe ministri i MFSK-së, Agim Çeku dhe sekretari i përgjithshëm, Shkëlzen Sylaj.

Ministri Çeku, fillimisht përshëndeti të pranishmet dhe i uroi për iniciativën e bashkëpunimit në fushën e sigurisë, duke iu ofruar atyre mbështetje të mëtutjeshme

Zeqiraj gjithashtu tha: "Jemi ne që vullnetarisht dhe me kënaqësi bartim këtë uniformë nëpërmjet se cilës identifikohemi me institucionin duke bartur kështu simbollet e shtetit tonë. Më tej major Remzie Zeqiraj tha: "Shërbimi ynë përkundër që është përgjegjësi dhe sfidë, njëkohësisht është edhe kënaqësi dhe krenari për ne që kemi marr obligim të kujdesemi për imazhin e institucionit dhe shtetit"

Major Zeqiraj prezantoi para të pranishmëve edhe temën "Kontributi dhe perspektiva e femrave në MFSK" ku theksoi se femrat e angazhuara në MFSK dhe FSK tani shërbejnë në detyrën e ushtarit, nënoficerit dhe oficerit, kryejnë me përgjegjësi urdhrat që jepen nga zinxhiri komandues, pavarësisht statusit



civile, inteligjencë, administratë, etj" Po ashtu femra në FSK është e angazhuar me detyra edhe në zinxhirin komandues, pra komandante, zëvendëskomandant, si

gjinore në MFSK dhe FSK", ku ndër të tjera tha se është një dimension jetësor, tashmë i shtrirë në politika dhe plane të zbatimit në të gjitha nivelet, në të gjitha njësitet, brigadat, batalionet, departamentet, sektorët dhe zyrat. Duke u përqendruar në fushën e sigurisë, roli i grave gjithnjë e më shumë po bëhet i rëndësishëm si në: operacione, menaxhimin e krizave të mundshme, vendimmarrje etj. Ajo ndër të tjera u shpreh: " Numri i femrave në pozita vendimmarrëse në MFSK ka një ngritje të konsiderueshme. MFSK-ja i ka kushtuar rëndësi të veçantë pjesëmarrjes së femrave në pozita vendimmarrëse, ku aktualisht përqindja e femrave të personelit civil në MFSK është 33.06%, kurse me uniformë 8.09% përkatësisht 183 femra në uniformë në gradën e oficerit dhe nënoficerit".

Në takimin e femrave që shërbejnë me uniformë në institucionet e sigurisë së vendit, me temën: "Kontributi dhe perspektiva e femrave në Forcat e Armatosura të Letonisë" u paraqit këshilltarja e NATO-s për FSK, zonja

Vineta Kleine. Ajo bëri edhe një krahasim ndërmjet përvojave të ushtarakeve të FSK-së dhe atyre të Letonisë, duke qenë njohëse e mirë tanimë edhe e rrethanave në FSK dhe Kosovë.

Nga ky takim ku pjesëmarrëse ishin përfaqësueset e MFSK-së dhe FSK-së, Policisë së Kosovës, Shërbimit Doganor, Shërbimit Korrektues, Shërbimit Sprovues, u diskutuan modalitetet e bashkëpunimit, si dhe u propozuan disa ide konkrete për bashkëpunim të cilat u vendos që të diskutohen në secilin prej institucioneve pjesëmarrëse veç e veç, në mënyrë që bashkëpunimi të konkretizohet. Secili institucion të ndërtojë asociacionin; asociacionet të ndërtojnë një trup të përbashkët koordinues; bashkëpunimi të vazhdohet me përfaqësim të tri ranqeve më të larta të femrave në uniformë të të katër institucioneve, që do të përbënte një lloj trupi koordinues të përbashkët; bashkëpunimin ta koordinojnë Zyra për të Drejtat e Njeriut dhe ajo për Barazi Gjinore.



në fuqizimin dhe vendimmarrjen e femrave në institucionet e Kosovës. A ndër të tjera në fjalën e tij tha: "E çmoj lart kontributin e femrës në FSK, e cila në përqindje është më e kënaqshme se në disa vende të NATO-s, por ne do të bëjmë edhe më shumë që të kemi progres edhe më të madh në ngritjen e kësaj përqindjeje si dhe në avancimin e femrës në institucionin tonë. Femrat në FSK po luajnë rol të jashtëzakonshëm në afirmimin e FSK-së, si forcë gjithëpërfshirëse, e cila po ngrihet dhe ndërtohet sipas standardeve të NATO-s" përfundoi ministri Çeku.

Nikoqiri i këtij takimi major Remzie Zeqiraj, oficerë për Marrëdhënie me Publikun, në fjalën e saj të rastit theksoi arsyet se pse është i rëndësishëm bashkëpunimi ndërmjet femrave që shërbejnë në institucionet e sigurisë, e ne veçanti atyre që shërbejnë në uniformë. Major

të tyre social dhe angazhimit familjar, ja dalin të jenë në hap me kolegët në të gjitha angazhimet në punë. Ajo tha se femrat në MFSK dhe FSK, tani më kanë ndërtuar një përvojë, e kanë përgatitjen shkollore dhe ngritjen profesionale të nevojshme për të qenë të suksesshme dhe produktive në punë. Kanë arritur që të jenë aktive dhe në ngritje profesionale me trajnime të nevojshme dhe adekuate për detyrat. "Pjesëtare e FSK-së kudo ku janë paraqitur, si brenda vendit ashtu edhe jashtë vendit, janë dalluar në trajnime dhe operacione. Ushtaraket tona janë të përkushtuara në zbatimin e detyrave, respektimin e zinxhirit komandues dhe gjithsesi aplikojnë edhe kreativitetin si dhe vetiniciativën duke dhënë kontribut në profile specifike si mjekësi, deminim, kërkim-shpëtim, reagim të shpejtë, logjistikë, polici, financa, marrëdhënie publike, marrëdhënie ushtarake

dhe udhëheqëse departamentesh e sektorësh" përfundoi major Zeqiraj.

Po ashtu edhe zonja Halime Morina, shefe e Njesisë për të Drejtat e Njeriut, për të pranishmet prezantoi temën "Perspektiva



Certifikohen 25 kadetë të FSK-së, në Kërkim-Shpëtim në Dimër

Për një muaj rresht 25 pjesëtarë të FSK-së, kanë kryer një trajnim të kërkim-shpëtimit në kushte dhe rrethana dimri. Pjesa teorike është kryer në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), në hapësirat e Qendrës Specialistike të Stërvitjes në Ferizaj, ndërsa pjesa praktike në terrenet e improvizuara malore, në malet e fshatit Strazhë të Komunës së Kaçanikut.

Ky trajnim është realizuar në kuadër të planit kalendarik të trajnimeve, që e ka planifikuar Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes së FSK-së. Trajnimi ka filluar më 20 janar dhe ka përfunduar më 21 shkurt 2014.

Trajnimi është realizuar nga instruktorët e Qendrës Specialistike të Stërvitjes (QSS) të FSK-së, të cilët me sukses kanë



trajtuar temat lidhur me menaxhimin e kërkim-shpëtimit në dimër, topografinë dhe ndihmën e parë.

Pjesa praktike e kërkim-shpëtimit në dimër, ka qenë shumë sfiduese për pjesëtarët e FSK-së dhe për instruktorët të cilët e kanë ndjekur

këtë kurs.

Edhe përkundër sfidave dhe terrenit mjaft të vështirë, kadetët janë dalluar me angazhimin e tyre maksimal në realizimin me sukses të këtij trajnimi. Ata kanë qenë mjaft të motivuar dhe të angazhuar, edhe pse kursi ishte i

mbyllur, ritmi i angazhimeve nuk ndryshoi asnjëherë për 30 ditë sa zgjati pjesa teorike dhe praktike, si në hapësirat e Qendrës Specialistike të Stërvitjes, po ashtu edhe në malet e fshatit Strazhë. Kjo ishte një garë brenda ekipeve për të arritur më të mirën nga kursi.

Vlen të theksohet se njohuritë e marra nga ekipet e NATO-s, instruktorët e FSK-së, me sukses po i praktikojnë në terren, për t'i përgatitur profesionalisht pjesëtarët e të gjitha njësive të FSK-së, jo vetëm në kërkim-shpëtim në dimër, por edhe në disiplina të tjera.

Në ceremoninë e certifikimit morën pjesë oficerët e stafit udhëheqës, të cilët për kadetët ndanë "certifikata" për kryerjen me sukses të trajnimit të kërkim-shpëtimit në dimër.



Trajnim i suksesshëm i pjesëtarëve të FSK-së në Kampin e KFOR-it Gjerman në Prizren

Në Kampin Gjerman në Prizren, ditë më parë, ka përfunduar me sukses trajnimi i mbajtur, në organizim të NLAT-it dhe në bashkëpunim me; J1/G1, të MFSK-së dhe KFT-së, ku koordinator i FSK-së ishte kolonel Bajram Uka.

Qëllimi i trajnimit, sipas kolonelit Uka, ishte identifikimi i fushave të personelit si: sfidat e tanishme, mënyrat e bashkëpunimit në mes NLAT-it dhe J1/G1 të FSK-së, në të ardhmen, etj. Nevoja për diskutim ndërmjet MFSK-së dhe KFT-së për të kri-

juar një urë bashkëpunimi në nivelin strategjik dhe operacional, kërkesat për këshillim dhe mbështetje në fusha të caktuara, etj.

Në këtë drejtim, për punë profesionale dhe angazhim maksimal u dallua koloneli gjerman Alfred Marsteller, për përgatitjen, trajnimin dhe akomodimin, gjatë kohës së mbajtjes së trajnimit, në Kampin Gjerman në Prizren. Pjesëtarët e J1/G1 të MFSK-së, FSK-së, janë njoftuar edhe me temat që kanë të bëjnë me funksionimin e personelit (në

Kampin Gjerman), detyrat dhe përgjegjësitë e përgjithshme si dhe përvojat e ndryshme nga menaxhimi i burimeve njerëzore duke marrë në shqyrtim modelet e shteteve të ndryshme, pastaj për detyrat dhe përgjegjësitë e personelit gjatë përgatitjeve të njësive për operacione dhe zbatim jashtë vendit, si dhe për temat, kujdesin, mbështetjen dhe mirëqenien e personelit në operacione jashtë vendit.

Të gjithë pjesëmarrësit gjatë trajnimit, temat e mësuara, praktikisht i kanë ushtruar në Kampin



Gjerman, në grupe dhe në mënyrë individuale. Në fund, të gjithë pjesëmarrësit

janë pajisur me certifikata për pjesëmarrjen dhe arritjen e rezultateve në trajnim.



Një tog i FSK-së udhëtoi për një trajnim të specializuar në Turqi

Më 23 shkurt, në kazermën "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore (KFT), është rreshtuar një tog i FSK-së, prej 22 pjesëtarësh të Brigadës për Reagim të Shpejtë, (BRSH) me gradën nëntoger-ushtar, të cilët udhëtuan për një trajnim të specializuar në Turqi. Qëllimi i këtij trajnimi është përgatitja e pjesëtarëve të FSK-së, në mënyrë sa më profesionale, për përballjen me dimër të ftohtë dhe me acar. Trajnimi në poligonet ushtarake të Turqisë, "Mbijetesë në dimër të ftohtë dhe të ashpër", do të mbahet nga 23 shkurt 2014 deri më 08 mars 2014.

Ky trajnim si dhe trajnimet e mëparshme të pjesëtarëve të FSK-së, në poligonet e Ushtrisë së Turqisë, po realizohen në bazë të Memorandumit të bashkëpunimit dypalësh në mes MFSK-FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Turqisë dhe Ushtrisë së Turqisë. Për të përcjellë ushtarët e FSK-së, kishin ardhur shefi i Shtabit të KFT-së kolonel Naim Haziri dhe shefi i Shtabit të Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH), nënkolonel Jeton Dreshaj, si dhe përfaqësuesi i Ushtrisë së Turqisë.

Me këtë rast, koloneli Naim Haziri u shprehë se ndjehet tejet i lumtur



që Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Turqisë dhe Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë së Turqisë,

kanë ofruar mundësi trajnimi për FSK-në, për trajnimin "Mbijetesën në dimër të ftohtë dhe të ashpër",

dhe kjo po ndodh pikërisht në repartet dhe poligonet ushtarake të Ushtrisë së Turqisë, tha koloneli Haziri, cili pastaj i përshëndeti të gjithë pjesëtarët e FSK-së, për të shprehur bindjen e tij, se gjatë këtij trajnimi pjesëtarët e FSK-së, do të arrijnë që të përfaqësojnë denjësisht FSK-në, sikurse edhe herëve tjera.

Në fund, koloneli Haziri kërkoi nga ushtarët e FSK-së, që gjatë trajnimit të përfitojnë sa më shumë njohuri nga Ushtria e Republikës së Turqisë, si dhe këto njohuri t'i zbatojnë, pastaj, me përpikëri në njësitet e tyre në FSK.